

KËSHILLI KOMBËTAR I PAGESAVE

TERMAT E REFERENCËS

I. Hyrje

Në vazhden e angazhimeve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), bankave komerciale dhe Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (Thesari-MEF) me qëllim të avancimit të sistemit kombëtar të pagesave në Kosovë

BQK-ja, bankat komerciale të përfshira në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës (ShBK) dhe Thesari-MEF pajtohen të themelojnë Këshillin Kombëtar të Pagesave siç është përcaktuar në këto Terma të Referencës.

II. Objektivat

Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP) synon të mbështesë arritjen e sistemeve të qëndrueshme dhe efikase për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë në Kosovë. Ai gjithashtu mund të shërbejë si një forum për bashkëpunim për sigurimin e kushteve të duhura në sistemet rajonale dhe ndërkombëtare të pagesave.

III. Detyrat kryesore

- a. KKP-ja funksionon për të lehtësuar bashkëpunimin e nevojshëm mes bankave dhe akterëve të tjerë kryesorë në fushën e pagesave.
- b. KKP-ja promovon iniciativa të përbashkëta për zbatimin e infrastrukturës së sistemit të pagesave. Këto iniciativa nuk duhet të pengojnë, dhe në fakt duhet të nxisin, konkurrencën e shëndoshë mes pjesëmarrësve të tregut.
- c. KKP-ja luan një rol kyç në përgatitjen e dokumenteve strategjike për arkitekturën e përgjithshme të sistemit të pagesave në vend.
- d. KKP-ja luan një rol kyç në monitorimin dhe zbatimin e reformave të sistemit të pagesave.
- e. KKP-ja luan një rol kyç për të lehtësuar shkëmbimin e informatave mbi nevojat ekonomike dhe afariste të palëve të ndikuara nga sistemi i pagesave.
- f. KKP-ja ndihmon në identifikimin e ndikimit të opsioneve të ndryshme në operacionet afariste dhe ditore të pjesëmarrësve dhe në interesat e shfrytëzuesve të fundit.
- g. KKP-ja luan një rol kyç në përzgjedhjen e parimeve dhe opsioneve për dizajnët e sistemeve.
- h. KKP-ja luan një rol kyç në caktimin e prioritetit të afateve të projekteve individuale sa i përket lansimit, financimit dhe zbatimit.
- i. KKP-ja promovon standardizimin e procedurave dhe sistemeve.
- j. KKP-ja është përgjegjëse për promovimin e njohurive mbi çështjet e sistemit të pagesave në vend. Për këtë qëllim, KKP-ja shfrytëzon çdo mjet që mund ta konsiderojë të duhur (punëtoritë, seminarët, faqet e internetit, reklamat në media, buletinet informative, etj.).
- k. KKP-ja angazhohet të promovojë bashkëpunimin mes të gjitha institucioneve aktive në sistemet e pagesave dhe të letrave me vlerë brenda rajonit dhe në nivel ndërkombëtar.

IV. Metodologjia

- a. KKP-ja përgatit raporte *ad hoc* mbi çështje të sistemit të pagesave. Raportet nuk do të jenë të natyrës normative. Megjithatë, ato do të shërbenin si një referencë për reformat aktuale të sistemit të pagesave në vend.
- b. KKP-ja do të formojë grupe punuese *ad hoc* lidhur me çështjet e pagesave. Grupet punuese mund apo mund të mos jenë të përbëra nga të tëra institucionet e përfaqësuara në KKP.
- c. KKP-ja përgatit dhe publikon raporte vjetore lidhur me aktivitetet e veta.

V. Përfaqësimi dhe struktura organizative

- a. Bankat dhe akterët e tjerë kryesorë të sistemeve për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë do të përfaqësohen në KKP. Fillimisht, do të përshihen: BQK-ja, ShBK-ja dhe bankat komerciale të përfaqësuara në Bordin drejtues të ShBK-së si dhe Thesari-MEF-i. Anëtarë të tjerë potencialisht mund të jenë institucionet e tjera financiare, institucionet e tregtimit të letrave me vlerë, shfrytëzuesit e fundit dhe kompanitë e mëdha (të shërbimeve publike, të telekomunikimit, etj.).
- b. KKP-ja ka një strukturë formale me guvernatorin/zëvendësguvernatorin e BQK-së si kryesues dhe sekretariati i tij gjithashtu sigurohet nga BQK-ja.
- c. Përfaqësuesit e caktuar të akterëve janë kryeshefat ekzekutivë (drejtorët menaxhues) të tyre. KKP-ja do të ftojë një numër të duhur të ekspertëve në mbledhjet e veta. Përbërja e pjesëmarrësve në mbledhjet e KKP-së duhet të jetë në përputhje me objektivin për të pasur diskutime efektive.
- d. Në fazën më të hershme të funksionimit të vet, KKP-ja mund të kërkojë, nëse është e nevojshme, asistencë nga entitetet e tjera vendore dhe ndërkombëtare me përvojë të madhe në menaxhimin e grupimeve të sistemeve të pagesave.
- e. KKP-ja mund të ftojë, nëse është e nevojshme, edhe institucione dhe/apo ekspertë individualë të tjerë për të marrë pjesë në mbledhjet e veta.

Këto Terma të Referencës janë dakorduar më 9 mars, 2010 dhe do të rishikohen sipas nevojës.